

ARTAN XHAFERAJ

**MBI NDARJEN NË RROKJE TË GRUPEVE DYSHE
TË BASHKËTINGËLLOREVE NË POZICIONIN NDËRZANOR**

Në fushën e fonetikës së shqipes, një prej çështjeve mjaft të ndërlikuara është ndarja fonetike e fjalëve në rrokje. Një trajtim i zgjeruar për këtë çështje është bërë nga Dodi (2004), i cili, falë njohjes së sigurt të literaturës bashkëkohore, ka evidentuar qartazi edhe të metat e teorive kryesore të rrokjes, mbështetur në materialin e gjuhës shqipe. Por, me gjithë punën e kryer dhe rezultatet e rëndësishme që janë arritur, pozicionet e gjuhëtarëve për ndarjen fonetike të fjalëve në rrokje janë të ndryshme. Një nga këto arsye është së në literaturën gjuhësore nuk ka një përkufizim konstant për rrokjen si njësi gjuhësore. Në këtë trajtesë për ndarjen e fjalëve në rrokje do të mbështetim disa rregulla ekzistuese duke sjellë argumente të reja e duke bërë disa plotësime për t'i bërë ato më bindëse, duke synuar përmirësimin, thjeshtimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Do të përqendrohemi te kufiri rrokjesor, kur kemi dy bashkëtingëllore midis zanoresh, duke u mbështetur te parimi i sonoritetit të tingujve (Sonority Sequencing Principle), ligji i kontaktit të rrokjes (Syllable Contact Law), parimi i përndarjes (Dispersion Principle) dhe parimi i maksimalizimit të onsetit të rrokjes (Maximum Onset Principle). Gjithashtu, do të sjellim fakte konkrete që vënë në dyshim vlerën e rregullës fonotaktike, sipas së cilës kur kemi dy a më shumë bashkëtingëllore midis zanoresh, ato shkojnë bashkë, në qoftë se në gjuhë ekzistojnë fjalë që fillojnë me e atë grup bashkëtingëlloresh.

* * *

Siç e dimë nga studimet në fushën e fonetikës, *teoria e sonoritetit*, e cila mbështetet në kritere akustike, e shpjegon më qartë thelbin e rrokjes dhe e zgjidh më mirë problemin e kufirit rrokjesor, pavarësisht nga kritikata që mund t'i bëhen. Sipas kësaj teorie, rrokja përfaqëson bashkimin e një elementi më tingëllues, me një element më pak tingëllues (Dodi, 2004). Sonoriteti i rrokjes rritet nga onseti drejt kulmit (të rrokjes) dhe më pas fillon të bjerë shkallë-shkallë nga kulmi drejt kodës. Pra, profili ideal i sonoritetit të rrokjes është i ulët në kufij dhe i lartë në kulm (Eddington et al. 2013a). Ndërsa ky parim ka përjashtime dhe shtron çështje për diskutim, ai pasqyron një prirje të fortë ndërgjuhësore dhe përfaqëson një nga parimet shpjeguese të rendit më të lartë të teorisë fonologjike moderne (Clements, 1990). Duke u mbështetur në punën

e Sieversit (1881) dhe Jespersenit (1904), Clements (1990) jep këtë variant të teorisë së sonoritetit: *Ndërmjet çdo përbërësi të rrokjes dhe kulmit të saj, lejohen vetëm tingujt me shkallë më të lartë sonoriteti*.¹ Në literaturën gjuhësore tingujt më sonorë janë zanoret e ngritjes së ulët dhe më pak sonorë janë bashkëtingëlloret mbylltore të shurdhëta. Klasifikimi i tingujve të shqipes sipas rritjes së sonoritetit është paraqitur nga Dodi (2004), mbështetur në klasifikimin e Jespersenit (1904), si më poshtë: Mbylltoret e shurdhëta₁ <Shtegoret e shurdhëta₂ <Mbylltoret e zëshme₃ < Shtegoret e zëshme₄ <Hundoret₅ <Anësoret₆ <Dridhëset₇ <Glaidet₈ <Zanoret e ng. së lartë₉ <Zanoret e ng. së mesme₁₀ <Zanoret e ng. së lartë₁₁.

Një shembull i mirë i teorisë së sonoritetit në gjuhën shqipe janë fjalët njërrokëshe me strukturë rrokjesore BBZBB, si: *krimb, kresht, krushk, brisk, psalt, prift, prind, trand, tremb, trung, trust* etj. Më konkretisht, te fjala *prift*, bashkëtingëlloerja e parë e fillimit të rrokjes është mbylltorja e shurdhët /p/, e cila, në shkallëzimin e sonoritetit të tingujve, ka sonoritetin më të ulët; pas saj vjen dridhësja /r/, e cila është më sonore se /p/-ja. Sonoriteti vazhdon të rritet drejt zanores /i/ (me sonoritet maksimal), që përfaqëson kulmin e rrokjes dhe më pas fillon të bjerë pak nga pak drejt bishtit të rrokjes: fillimisht te shtegorja /f/, e cila është më sonore se mbylltorja e shurdhët /t/ në fund të fjalës.

Clements (1990) ka vërejtur se në fillim të rrokjes diferencat e mëdha në tingëllim parapëlqehen mbi të voglat, duke bërë që /pj-/ të jetë një onsets më i mirë se /lj-/, ndërsa në rimë preferohen diferencat e vogla në tingëllim, duke bërë që /-j/ të jetë një kodë më e mirë se /-t/ (cit. sipas Gussenhoven dhe Jacobs, 2011: 165). Me sa duket, sipas Clements-it (po aty, f. 165-166) rrokjet preferojnë të fillojnë me një zhurmë dhe të mbarojnë me një fishkëllimë, me arsyetimin se fillimi i rrokjes është shumë i rëndësishëm, sepse tërheq vëmendjen e dëgjuesit kur duhet; ndoshta arsyeja për këtë konstatim është perceptivë. Rrokjet kanë prirje të grupohen në fjalë në mënyrë që sonoriteti në fund të rrokjes [paraardhëse] të jetë më i madh sesa ai i fillimit të rrokjes tjetër [pasardhëse], duke favorizuar më tepër një tranzicion fishkëllimë-zhurmë, sesa zhurmë-fishkëllimë. (Gussenhoven dhe Jacobs, 2011). Këto prirje shpjegohen më qartë përmes *ligjit të kontaktit të rrokjes* (Syllable Contact Law). Ky ligj është përshtetur fillimisht nga Vennemann (1972), pastaj Hooper (1976), Murray dhe Vennemann (1983), Clements (1990) etj. Sipas Murray dhe Vennemann-it (1983:520), preferenca për strukturën rrokjesore A \$ B, ku A dhe B janë segmente marginale dhe a dhe b janë përkatësisht vlerat e

¹ G. N. Clements (1990). *The role of the sonority cycle in core syllabification*. In J. Kingston and M. E. Beckman (eds), "Papers in laboratory phonology I. Between the grammar and physics of speech". Cambridge: Cambridge University Press, 283-333. "Between any member of a syllable and the syllable peak, only sounds of higher sonority rank are permitted."

sonoritetit të A-së dhe B-së, rritet me vlerën e a minus b. Ky formulim, sipas Clements-it (1990), e shtrin ligjin e kontaktit të rrokjes në kontaktin e rrokjeve të të gjitha llojeve, duke përfshirë edhe kontaktin B-Z. Si rrjedhim, sekuencat si [ik-a] bëhen shembulli më i keq i mundshëm i kontaktit të rrokjes, ndërsa [i-ka] më i miri. Por më thjeshtë këtë ligj e ka shpjeguar Hooper (1976) dhe e ka paraqitur Clements (1990), si më poshtë: *Në çdo sekuencë $C_a \$ C_b$, preferohet që C_a t'ia kalojë C_b në sonoritet.*² Për shembull, në fjalën [par-ket] kufiri rrokjesor kalon midis dy bashkëtingëlloreve, sepse /r/-ja është më sonore se /k/-ja. Kështu që, edhe sipas Gussenhoven dhe Jacobs (2011), kur shqyrtojmë lidhjen midis rrokjeve, prirja është të shtojmë në maksimum zhurmën në onsets.

Përgjithësisht, nga autorët që kanë trajtuar ligjin e kontaktit të rrokjes, sipas Parker-it (2002), në shumicën e analizave dy kushte të qarta janë të nevojshme: *e para*, ligji i përshtatshëm i kontaktit të rrokjes është shprehur në një farë mënyre në përkufizimin e Murray dhe Vennemann-it; *e dyta*, kushti që kufizon zbatimin e rregullit, i cili është quajtur Pjerrësia e Kontaktit të Rrokjes (Bat-El, 1996; Shin, 1997; Davis, 1998 [Syllable Contact Slope]), apo Pjerrësia e Konturit të Sonoritetit (Rose, 2000 [Sonority Contour Slope]), ndërmjetësor shkallën relative të thyerjes së kontaktit të rrokjes të lejuar në çdo gjuhë, normalisht në një mënyrë të pjerrët. Por, siç ka vërejtur Clements (1990), vetë ligji i kontaktit të rrokjes dhe kufizimi i pjerrësisë, janë të lidhura me *parimin e përndarjes së sonoritetit* (Sonority Dispersion Principle). Për ta kuptuar më qartë këtë parim Clements (1990) shpjegon nocionin e gjysmërrokjes: *Rrokja ndahet në dy pjesë të mbivendosura që quhen gjysmërrokje: bërthama e rrokjes u përket të dyja pjesëve njëkohësisht*. Sipas këtij autori, gjysmërrokja është një sekuencë maksimale e segmenteve tautosilabike të formës $C_m \dots C_n V$ ose $VC_m \dots C_n$, ku $n \geq m \geq 0$. Ideja që qëndron në themel të përdorimit të gjysmërrokjes, është që profili i sonoritetit të pjesës së parë të rrokjes është i pavarur nga profili i sonoritetit të pjesës së dytë. Kështu që, tipari “përndarje në sonoritet” përcaktohet më së miri mbi gjysmërrokjen.

Parimi i përndarjes sipas Clements (1992):

a. *Gjysmërrokja nistore e preferuar rrit në maksimum përndarjen e sonoritetit;*

b. *Gjysmërrokja fundore e preferuar zvogëlon përndarjen e sonoritetit.*

Ta ilustruojmë me një shembull. Në fjalën njërrrokëshe *qan* gjysmërrokja nistore në të majtë është [qa], kurse gjysmërrokja e dytë, në të djathtë, është [an]. Në gjysmërrokjen e parë sonoriteti rritet nga mbylltorja /q/ te zanorja /a/, pra kemi një dispercion maksimal, ndërsa në gjysmërrokjen e dytë kemi një dispercion më të vogël, sepse sonoriteti bie nga zanorja /a/ te hundorja /n/.

² G. N. Clements (1990). Po aty, “In any sequence $C_a \$ C_b$, there is a preference for C_a to exceed C_b in sonority”. C_a është bashkëtingëllozja e parë, C_b është bashkëtingëllozja e dytë, kurse simboli (\$) përcakton kufirin e rrokjes.

Dhe së fundi, një tjetër parim universal që lidhet me kufirin e rrokjes është *parimi i maksimalizimit të onsetit* (Maximum Onset Principle). Sipas këtij parimi, bashkëtingëlloret ndërzanore vendosen maksimalisht në onsetin e rrokjes duke marrë parasysh edhe kufizimet e gjuhës. Parimi i maksimalizimit të onsetit, i propozuar nga Kahn (1976), kërkon që fillimisht të ndërtojme onsetin e rrokjes aq gjatë sa mund të lejohet, pastaj të formojmë një kodë të pranueshme. P.sh., në gjuhën shqipe, sipas këtij parimi, fjala *liri* do të ndahej në rrokje [li-ri] dhe jo *[li-ri]; fjala *problemi* do të ndahej [pro-ble-mi] dhe jo *[prob-le-mi] etj. Prania e bashkëtingëllores ndërzanore në onsetin e rrokjes së dytë, më mirë se në kodën e së parës, është universale (Gussenhoven dhe Jacobs, 2011), kështu që bashkëtingëlloret parapëlqejnë të jenë pjesë e onsetit, sesa e kodës, nëse struktura rrokjesore nuk ka kufizime.

Duke u mbështetur në këto parime a rregulla fonetike, në gjuhën shqipe mund të bëhen analiza fonetike më të sigurta për përcaktimin e kufirit të rrokjes dhe të jepen zgjidhje më të qëndrueshme për rastet problematike me grupe bashkëtingëlloresh midis zanoresh.


Për të parë në praktikë zbatimin rregullave të ndarjes së fjalëve në rrokje, ne zhvilluam një anketë me 100 nxënës të moshës 9-10 vjeç në dy shkolla 9-vjeçare të qytetit të Vlorës: 44 pjesëmarrës nga shkolla nëntëvjeçare “Muço Delo” dhe 56 pjesëmarrës nga shkolla nëntëvjeçare “Ismail Qemali”. Për të mos u ndikuar nxënësit nga njëri-tjetri, ishim të pranishëm në klasë për të shpjeguar natyrën e pyetësorit. Sipas dëshirës, nxënësit do të ndanin në rrokje fjalë me grupe bashkëtingëlloresh në pozicionin ndërzanor. Nëse ndonjë nxënës do të harronte të ndante ndonjë fjalë në rrokje, ia jepnim fletën dhe ai e plotësonte në çast. Rezultatet e detajuara të pyetësorit janë paraqitur në tabelën 6 në shtojcë.

Përgjithësisht, përcaktimi i kufirit rrokjesor, kur kemi dy bashkëtingëllore të zhurmëta, apo dy sonante midis zanoresh, paraqet më tepër vështirësi, sesa grupi e *zhurmët + sonante* dhe *sonante + e zhurmët* midis zanoresh. Në rastet kur kemi grupin *dysh e zhurmët + sonante* midis zanoresh, bashkëtingëlloret formojnë rrokje me zanoren pasuese (Dodi, 2004). Ky rast është në përputhje të plotë e teorinë e sonoritetit. Mirëpo rregulla, sipas së cilës, kur kemi dy a më shumë bashkëtingëllore midis zanoresh, ato shkojnë bashkë, në qoftë se në gjuhë ekzistojnë fjalë që fillojnë me atë grup bashkëtingëlloresh; në rast të kundërt ato ndahen, thellon kontradiktat në përcaktimin e kufirit rrokjesor.

Le ta ilustrojmë më konkretisht me fjalët *misra* dhe *mishra*. Me grupin /-sr-/ nuk fillojnë fjalë të shqipes, ndërsa me grupin /-shr-/ fillojnë. Sipas kësaj rregulle, kufiri i rrokjes kalon midis bashkëtingëlloreve /s/ dhe /r/ në fjalën [mis-ra], kurse /sh/-ja dhe /r/-ja formojnë rrokje me zanoren pasuese në fjalën [mi-shra]. Në të dyja rastet, midis kulmeve të sonoritetit [zanoret i dhe a] kemi një shtegore të shurdhët që ndiqet nga një sonore dridhëse, pra kemi të njëjtin

perceptim dëgjimor. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim kurbën e sonoritetit të këtyre fjalëve.³

Tabela 1. Kurba e sonoritetit të fjalëve *misra* dhe *mishra*.



Dodi e ka vënë në dyshim vlerën e rregullës së mësipërme duke u shprehur qartë se fjala *misri* ndahet [mi-sri], edhe pse me grupin /-sr-/ nuk fillojnë fjalë të shqipes. Sipas të dhënave të anketës shumica e pjesëmarrësve i vendosën të dy grupet /-sr-/ (82%) dhe /-shr-/ (70%) në onsetin e rrokjes së dytë. Siç shihet qartë edhe nga tabela e mësipërme, pjerrësia e vijës së sonoritetit është e njëjtë tek të dyja fjalët, kështu që, edhe për mendimin tonë, ndarja në rrokje duhet të jetë e njëjtë: grupi dysh i bashkëtingëlloreve e *zhurmët* + *sonante* të formojë rrokje me zanoren pasuese. Në këtë mënyrë rregulla bëhet më përgjithësuese: është në pajtim të plotë me teorinë e sonoritetit dhe me parimin e maksimalizimit të onsetit, duke na dhënë edhe rrokje të hapura, që, sipas Dodit (2004: 133), përbëjnë modelin më të rëndomtë të rrokjes në gjuhën shqipe.


Gjithashtu, grupi dysh *sonante hundore* + *bashkëtingëllore e zhurmët* midis zanoresh formon rrokje me zanoren pasuese (Dodi, 2004:135). Mirëpo në gjuhën shqipe ekzistojnë më shumë se 15 grupe dyshe (hundore + e zhurmët), me të cilat nuk fillojnë fjalë të shqipes.⁴ Nëse marrim për shqyrtim fjalët *fanta* dhe *banka*, do të kishim këto ndarje në rrokje: *fan-ta* dhe *ba-nka*, sepse me grupin /-nt-/ nuk fillojnë fjalë të shqipes, ndërsa me grupin /-nk-/ fillojnë. Theksojmë, gjithashtu se /t/-ja dhe /k/-ja kanë të njëjtën shkallë sonoriteti: janë mbylltore shpërthyesë të shurdhëta. Prandaj nuk na duket zgjidhje e drejtë, e thjeshtë dhe më praktike që grupi /-nt-/ të ndahet dhe grupi /-nk-/ të shkojë me

³ Vlerat që janë vendosur në boshtin vertikal (0-11) në tabelë përcaktojnë shkallëzimin e sonoritetit të tingujve të shqipes sipas sistemit 11-shkallësh paraqitur nga Dodi.

⁴ Shih më gjerë punimin tonë *Rreth disa çështjeve të fonetikës së shqipes standarde*, në "Ndihmesa shkencore të prof. Rami Memushajt", Vlorë, 2014, f. 66.

zanoren pasuese. Edhe pjerrësia e vijës së sonoritetit të këto fjalë është e njëjtë (shih tab. 2). Megjithatë, dihet që sinjali akustik, që prodhohet në nyjëtimin e vazhduar, ndryshon në varësi të kontekstit. R. Wright (2004), në një studim për veçoritë akustike të bashkëtingëlloreve, thekson se të vetmet bashkëtingëllore që kanë gjurmë të sigurta në kulmet e ngushtimit të tyre, janë sibilantet frikative. Ndoshta, kjo është arsyeja pse rrokjet e tipit sBZ janë të zakonshme nga pikëpamja gjuhësore, edhe pse ato kanë përmbysje të sonoritetit. Gjurmët e /s/-së në sBZ janë më të dobëta se ato të B-së në BZ, prandaj ka shumë gjuhë që kanë BZ, por nuk kanë sBZ. Nëse vendi [i formimit] sakrifikohet, atëherë hundoret, gjithashtu, mund të paraqiten në përmbysje sonoriteti: gjurmët e mënyrës [së formimit] janë të qarta edhe në izolim, por gjurmët e vendit të formimit të tyre do të zhduken, duke i bërë ato homorganike me bashkëtingëlloren e zhurmët pasuese. (po ai, f. 52). Kjo dukuri shfaqet qartë në gjuhën shqipe, sepse grupet *mb, nd, ng, ngj, mp, nt, nk, nq* shqiptohen me një nyjëtim të vetëm dhe paraqiten si tinguj të përbërë. Në këto raste, edhe pjerrësia e vijës së sonoritetit është më e vogël se ajo që paraqitet në tabelën 2. Për këtë arsye mendojmë që rregulla e formuluar nga Dodi që grupi *hundore + e zhurmët* midis zanoresh formon rrokje me zanoren pasuese është më e pranueshme.


Tabela 2. Kurba e sonoritetit të fjalëve *fanta* dhe *banka*.



Grupet dyshe që formohen nga sonantet e tjera (dridhëse, anësore, mesore) + bashkëtingëllore e zhurmët midis zanoreve, ndahen, p.sh.: *por-ti, pal-ca, vaj-zë* etj. Ndarjet në rrokje të këtyre fjalëve janë në përputhje të plotë me ligjin e kontaktit të rrokjes, sepse bashkëtingëlloret /r/, /l/, /j/, që shfaqen në pozicionin e kodës, janë më sonore se bashkëtingëlloret /t/, /c/, dhe /z/, që shfaqen në pozicionin e onsetit, si dhe me parimin e përndarjes së sonoritetit, sepse në gjysmërrrokjet e para [po, pa, va] sonoriteti rritet maksimalisht, ndërsa në gjysmërrrokjet e dyta [or, al, aj] kemi një dispersion më të vogël.

Një situatë kontradiktore na paraqitet edhe në përcaktimin e kufirit rrokjesor, kur grupi përbëhet prej dy bashkëtingëlloreve të zhurmeta midis zanoresh në fjalët *pafta* dhe *nafta*. Kemi theksuar (2012) se nuk na duket zgjidhje e drejtë dhe më praktike që grupi /-fk-/ të ndahet në fjalën [paf-ka], sepse me të nuk fillojnë fjalë të shqipes, kurse grupi /-ft-/ të formojë rrokje me zanoren pasuese në fjalën [na-fta], sepse me të fillojnë fjalë të shqipes. Këto grupe kanë të njëjtin perceptim dëgjimor; edhe pjerrësia e vijës së sonoritetit të tyre në pozicionin ndërzanor është e njëjtë (shih tab. 3), rrjedhimisht, edhe prerja rrokjesore duhet të jetë e njëjtë. Për këtë arsye mbështetim rregullën e formuluar nga Dodi që, kur kemi dy bashkëtingëllore të zhurmeta midis zanoresh, të dyja bashkëtingëlloret shkojnë me zanoren e dytë. Edhe në këtë rast rregulla bëhet më përgjithësuese dhe është në përputhje të plotë me parimin e maksimalizimit të onsetit, sepse struktura rrokjesore e shqipes lejon grupe të tilla bashkëtingëlloresh të dalin si onset. Për sa i përket thyerjes (uljes) së sonoritetit në rrokjet jonistore, mendojmë se (këtu) është e papërfillshme, madje në literaturën gjuhësore, në shkallëzime më të thjeshta, bashkëtingëlloret e zhurmeta rreshtohen në të njëjtin shkallë të sonoritetit të tingujve. Sidoqoftë, siç theksuam edhe më lart, rrokjet me përmbysje të sonoritetit janë gjuhësisht të zakonshme (në anglisht *sponge* “sfungjer”, *star* “yjl”, *skin* “lëkurë”; në gjermanisht *stein* “gur”; në frëngjisht *stylo* “stilolaps”; në shqip *stinë*, *brisku* etj.), aq më tepër në gjuhën shqipe ku grupet *hundore* + *e zhurmet* (që kanë thyerje më të madhe; shih tab. 2), për shkak të veçorive nyjetimore, formojnë rrokje me zanoren pasuese. S’ka dyshim që thyerje të tilla të sonoritetit lidhen më lehtësinë që krijohet në shqiptimin e këtyre grupeve.


Tabela 3. Kurba e sonoritetit të fjalëve *nafta* dhe *kafka*.



Kontradikta shfaqet te kufiri rrokjesor edhe në ato fjalë që kanë në përbërjen e tyre dy sonante. Nëse zbatohet rregullën fonotaktike, grupi /-rj-/ duhet të ndahet në fjalën *larje*, sepse nuk shfaqet në pozicionin e onsetit, kurse grupi /-rrj-/ duhet të shkojë me zanoren pasuese në fjalën *marrje*. Theksojmë


që bashkëtingëlloret /r/ dhe /rr/ janë të dyja dridhëse. Sipas të dhënave të anketës, pjesëmarrësit preferuan të vendosnin grupet /-rj-/ (64%) dhe /-rrj-/ (52%) në onsetin e rrokjes së dytë. Fakti që 48% e pjesëmarrësve vendosën bashkëtingëlloren /rr/ në kodën e rrokjes së parë mund të lidhet me veçoritë nyjetimore të /rr/-së dhe jo me kufirin morfemor, sepse në të dy rastet kemi emra veprimi të formuar nga pjesore (lar-, marr-) + prapashtesën -je. Ashtu siç kemi argumentuar për rastet e mësipërme, edhe në këto fjalë prerja rrokjesore duhet të jetë e njëjtë (*la-rje, ma-rrje*), sepse grupet ndërzanore kanë të njëjtën pjerrësi të vijës së sonoritetit (shih tabelën 4).

Tabela 4. Kurba e sonoritetit të fjalëve *larje* dhe *marrje*.



Duke respektuar ndihmesën vlerëplotë të Dodit, po rimarrim grupet prej dy sonantesh midis zanoresh, duke bërë disa plotësime për t'i bërë ato më bindëse. Kështu, grupet /-jm-/ , /-jl-/ , /-jr-/ , ku /j/-ja paraqitet si element i parë i grupit, ndahen (*laj-mi, gaj-le, aj-ri*), kurse grupet /-mj-/ , /-rj-/ , /-rrj-/ , /-lj-/ , /-llj-/ , ku /j/-ja paraqitet si element i dytë, shkojnë me zanoren pasuese (*pa-mje, tharje, tje-rrje, shku-lje, sje-llje*). Gjithashtu, grupet /-rl-/ , /-rm-/ , /-rn-/ , /-rnj-/ , ku /r/-ja paraqitet si element i parë i grupit (përveç /-rj/-së, sepse /j/-ja është më sonore se /r/-ja), ndahen (*per-la, hur-ma, bar-na*), kurse grupi /-mr-/ shkon me zanoren pasuese (*ze-mra*).

Ndryshe nga Dodi, mendojmë që grupi /-rl-/ , ashtu si grupi /-rm-/ , të ndahet në rrokje të ndryshme në pozicionin ndërzanor, sepse edhe kurba e sonoritetit është pothuajse e njëjtë (shih në tab. 5 fjalët *perla* dhe *hurma*).

Tabela 5. Kurba e sonoritetit të fjalëve *perla* dhe *hurma*.

Ndarjet [per-la, hur-ma] janë në përputhje të plotë me ligjin e kontaktit të rrokjes, me parimin e përndarjes së sonoritetit dhe në këtë mënyrë rregulla bëhet më përfshirëse për rastet e grupeve prej dy sonantesh midis zanoresh me /r/-në si element i parë i grupit. Ndarjet e tjera në rrokje janë në përputhje të plotë me teorinë e sonoritetit.

Duke përfunduar, mund të themi se struktura e rrokjes në shqipe është komplekse për kombinime bashkëtingëlloresh, gjë që e bën të vështirë formulimin e rregullave për strukturën e përbërësve të saj. Sipas Memushajt (2015), shqipja standarde ka më pak kufizime nga disa gjuhë të tjera për sa i përket numrit të elementeve që mund të dalin në onset ose në kodë, për shembull, ka fjalë komplekse me katër bashkëtingëllore në onset si *shndrit* (BBBBZB), kurse në bisht të rrokjes mund të dalin jo më shumë se tri bashkëtingëllore si *kopsht* (BZBBB). Nëse një gjuhë lejon onsete dhe koda të tilla, është vështirë të japësh zgjidhje një herë e përgjithmonë për kufirin rrokjesor.

Në këtë trajtesë u përqendruam në ndarjen në rrokje të grupeve dyshe të bashkëtingëlloreve në pozicionin ndërzanor. Ne mendojmë se teoria e sonoritetit jep zgjidhje më të mira për kufirin e rrokjes në gjuhën shqipe. Sipas të dhënave të anketës, 82% e pjesëmarrësve vendosën dy bashkëtingëlloret në onsetin e rrokjes së dytë në fjalën [mi-sra], edhe pse shqipja s'ka fjalë që fillojnë me /sr/, pra, në këtë rast, aspekti fonetik mbizotëron ndaj rregullës fonotaktike. Ky argument vlen edhe për grupet /fk/, /nt/, rj, /lj/ etj. Kufiri morfemor dhe theksi i fjalës nuk ndikojnë në ndarjet e fjalëve në rrokje në përgjigjet e fëmijëve.

Nga sa kuptohet edhe nga rastet që u shqyrtuan më lart, nëse bazohemi në një analizë fonetike të detajuar të nyjetimit të një fjale a grupi të caktuar tingujsh, mbështetja në kritere fonotaktike thellon kontradiktat në përcaktimin e kufirit rrokjesor. Duke u mbështetur në teorinë dhe modelet e sonoritetit që

shtjelluam më sipër, mund të jepen zgjidhje më të drejta: rregullat për kufirin rrokjesor bëhen më të qarta, më përgjithësuese e më të thjeshta për t'u zbatuar në praktikë, duke shmangur përjashtimet për grupe bashkëtingëlloresh midis zanoresh me të njëjtën kurbë sonoriteti. Gjithashtu, është e nevojshme që për raste të tilla të bëhen studime eksperimentale në laborator. Sidoqoftë, në fjalë të veçanta në gjuhën shqipe, faktori fonologjik, struktura morfologjike e fjalës dhe roli i theksit mund të ndihmojnë në përcaktimin e kufirit rrokjesor.

BIBLIOGRAFI

- Beartsch, K. (2010), *Coda Formation vs. Onset Maximization: Issues in the Syllabification of VCV Sequences*, "Language Research", Vol. 46, No 1, 39-57.
- Beci, B. (2004), *Fonetika e gjuhës shqipe*, Tiranë: EDFFA.
- Belluscio, G., & Rrokaj, Sh. (2011), *Dizionario di equivalenza dei termini della linguistica - italiano, albanese, francese, inglese*. Arcavacata di Rende –Tiranë: Arbëria.
- Carr, Ph., & Honeybone, P. (2007), *English phonology and linguistic theory: an introduction to issues, and to "Issues in English Phonology"*. In "Language Sciences" 29, 117-153. Available online at www.sciencedirect.com. <https://doi.org/10.1016/j.langsci.2006.12.018>
- Clements, G. N. (1990), *The role of the sonority cycle in core syllabification*. In J. Kingston and M. E. Beckman, eds. "Papers in laboratory phonology" I. Cambridge: Cambridge University Press, 283-333.
- Clements, G. N. (1992), *The sonority cycle and syllable organization*. In Wolfgang U. Dressler, Hans C. Luschutzky, Oskar E. Pfeiffer and John R. Rennison, eds. "Phonologica" 1998. Cambridge: Cambridge University Press, 63-76.
- Crystal, D. (2008), *A dictionary of linguistics and phonetics* (6th ed.). Oxford, UK: Blackwell Publishing Ltd.
- Dodi, A. (2004), *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Eddington, D., Treiman, R., & Elzinga, D. (2013), *Syllabification of American English: Evidence from a Large-scale Experiment*. Part I, "Journal of Quantitative Linguistics", Vol. 20, No. 1, 45-67.
- Eddington, D., Treiman, R., & Elzinga, D. (2013), *Syllabification of American English: Evidence from a Large-scale Experiment*. Part II, "Journal of Quantitative Linguistics", Vol. 20, No. 2, 75-93.
- Goldsmith, J. (2011), *The Syllable*. In "The Handbook of Phonological Theory", Second Edition (eds J. Goldsmith, J. Riggle and A. C. L. Yu), Wiley-Blackwell, Oxford, UK.

- Gouskova, M. (2001), *Falling sonority onsets, loanwords and Syllable Contact*. In Andronis, Mary, Christopher Ball, Heidi Elston & Sylvian Neuvel (eds.), "CLS 38: The Main Session. Papers from the 38th Meeting of the Chicago Linguistic Society", Vol. 1. Chicago: CLS. 175- 186.
- Gussenhoven, C., & Jacobs, H. (2011), *Understanding phonology*. London: Hodder Education.
- Kahn, D. (1976), *Syllable-based generalizations in English phonology*. Doctoral dissertation, MIT, Cambridge, MA. [Maximum Onset Principle: First, make the onset as long as it legitimately can be; then form a legitimate coda.].
- Katamba, F. (1996), *An introduction to phonology* (Eighth impression). London: Longman.
- Ladefoged, P., & Johnson, K. (2011), *A Course in Phonetics*. (6th ed.), Boston: Wadsworth, Cengage Learning.
- Lodge, K. (2009), *A Critical Introduction to Phonetics*, London: Continuum international Publishing Group.
- Memushaj, R. (2015), *Fonetika e shqipes standarde*, Tiranë: Infobotues.
- Parker, S. G. (2002). *Quantifying the sonority hierarchy*. Doctoral dissertation. University of Massachusetts, Amherst.
- Wright, R. (2004), A review of perceptual cues and cue robustness. In B. Hayes, R. M. Kirchner and D. Steriade (eds.), "Phonetically Based Phonology", Cambridge: Cambridge University Press, 34-57.
- Xhaferaj, A. (2014), *Rreth disa çështjeve të fonetikës së shqipes standarde*, në "Ndihmesa shkencore të prof. Rami Memushajt", Vlorë: Triptik.

Shtojcë

Tabela 6. Përqindjet e përgjigjeve të dhëna nga subjektet për ndarjen në rrokje të grupeve dyshe të bashkëtingëlloreve në pozicionin ndërzanor

Lloji i grupit	Grupe që lejohen në onsets	Fjalët	Ndarja në rrokje		Grupe që nuk lejohen në onsets	Fjalët	Ndarja në rrokje	
			Z-BBZ %	ZB-BZ %			Z-BBZ %	ZB-BZ %
Zh+S	/shr/	<i>mishra</i>	70	30	/sr/	<i>misra</i>	82	18
SH+Zh	/nk/	<i>banka</i>	52	48	/nt/	<i>fanta</i>	55	45
S+Zh					/jz/	<i>vajzë</i>	27	73
					/rk/	<i>arka</i>	6	94
Zh+Zh	/ft/	<i>nafta</i>	77	23	/fk/	<i>paftka</i>	63	37
S+S	/rj/	<i>marrje</i>	52	48	/tj/	<i>larje</i>	63	37
	/mj/	<i>pamje</i>	76	24	/lj/	<i>dalje</i>	87	13
					/rl/	<i>perla</i>	31	69
					/jr/	<i>ajri</i>	5	95
	/mr/	<i>zemra</i>	60	40	/rm/	<i>hurma</i>	31	69

Shënim: Zh = e zhurmët, S = sonante, SH= sonante hundore. %, përqindja e atyre që preferuan ndarjen në rrokje Z-BBZose ZB-BZ (p.sh. 82% e pjesëmarrësve ndanë në rrokje fjalën *misra* në [mi-sra], ndërsa 18% në [mis-ra]).

SUMMARY

ON THE SYLLABLE DIVISION OF DOUBLE GROUPS OF CONSONANTS BETWEEN VOWELS

This paper has focused on syllabification of bi-consonantal clusters in intervocalic position. In the present research on syllabification, we support some of the existing rules by bringing new arguments and making some additions in order to make them more convincing, with a view to improving and simplifying their practical application. We focus on syllable boundary when there are two consonants between vowels, based on the Sonority Sequencing Principle, on the Syllable Contact Law, the Dispersion Principle and the Maximum Onset Principle.

We consider that the sonority theory offers better solutions to syllable boundary in Albanian. According to the data from our questionnaire, 82% of the subjects placed two consonants in the onset of the second syllable in [mi-

sra], even though Albanian has no word starting with /sr/; thus, in this case the phonetic aspect overrules the phonotactic rule. This argument also holds for the groups /fk/, /nt/, /rj/, /lj/ etc.

As it can be understood from the examples discussed above, if we focus on a detailed phonetic analysis of the articulation of a word or a certain group of sounds, relying on phonotactic criteria worsens the controversy on syllable boundary determination in Albanian. By contrast, if we resort to the Sonority Theory and the models we examined above, solutions that are more appropriate could be given: the rules of syllable boundary become clearer, more generalizing and simpler in practical application, by avoiding the exceptions for consonant groups in intervocalic position that possess the same sonority curve. Furthermore, we deem it necessary that experimental researches on such cases should be conducted in the future. However, for specific words in Albanian, the phonological factor, the morphological structure of a word and the role of stress may aid in determining syllable boundaries.

